

Prirja për të emigruar nga Kosova pas liberalizimit të vizave: ndikimi në fuqinë punëtore



Prirja për të emigruar nga Kosova
pas liberalizimit të vizave:
ndikimi në fuqinë punëtore

Janar 2024

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	5
Tregu aktual i punës në Kosovë	8
Prirja e qytetarëve të Kosovës për të emigruar në vitin 2024	11
Kërkesat për punë në vendet e BE-së	16
Trendi i emigrimit në Ballkanin Përqendror pas liberalizimit të vizave	18
Roli i politikave zhvillimore në zbutjen e prirjes për emigrim	21
Përfundime dhe rekomandime	24
Shtojca	25

Përmbledhje ekzekutive

Në dekadën e fundit, shkalla e emigrimit nga Ballkani Perëndimor drejt Bashkimit Evropian ka shënuar një rritje prej 10%, duke rezultuar në faktin që aktualisht rreth 20% e popullsisë së këtij rajoni jeton jashtë shteteve të origjinës. Me përjashtim të Kosovës, liberalizimi i vizave i ka mundësuar vendeve tjera të rajonit të lëvizin lirshëm në zonën Schengen të Bashkimit Evropian që nga periudha 2009–2010. Qytetarët e Kosovës për herë të parë po lëvizin pa viza nga data 1 janar 2024, pas vendimit të Komisionit Evropian për liberalizim të vizave për Kosovën.

Të dhënat tregojnë se në vitin e parë pas liberalizimit të vizave për shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, shkalla e emigrimit nuk ishte shumë e lartë, duke arritur në maksimum 2.9% të popullsisë së një shteti. Por, tendenca për të emigruar, në përjashtim të Malit të Zi, është bërë shumë më e theksuar në tërë Ballkanin Perëndimor pas vitit 2015. Kjo po shoqërohet edhe me një kërkesë të madhe dhe zbutje të kriterëve për punëtorë të huaj nga shtetet e BE-së. Në periudhën 2010–2022, rreth 23% e popullsisë së Shqipërisë ka emigruar dhe fituar lejeqëndrim për herë të parë në Bashkimin Evropian; gjithashtu, rreth 15% e popullsisë së Kosovës, 11% e popullsisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, 10% e popullsisë së Maqedonisë së Veriut, 6% e popullsisë së Serbisë, dhe 4% e popullsisë së Malit të Zi kanë ndjekur të njejtën rrugë emigrimi.

Liberalizimi i vizave e gjen Kosovën në një dinamikë më ndryshe se shtetet tjera të rajonit në kohën kur atyre i'u ofrua lëvizja e lirë në BE. Nga viti 2012 deri në vitin 2022, nga Kosova kanë emigruar mbi 338 mijë qytetarë. Vetëm në vitin 2022 kanë emigruar 41,553 qytetarë dhe në këtë vit fuqia punëtore aktive është zvogëluar për 21,571 persona, ndërsa fuqia punëtore jo-aktive është zvogëluar

për 14,698 persona. Në rast se nuk kemi një aktivizim të fuqisë punëtore jo-aktive, e cila është mjaft e lartë, aktualisht zëvendësimi i fuqisë punëtore së munguar nga imigrantë të huaj, sikurse nga Bangladeshi, Turqia, Nepali etj., është i pamjaftueshëm. Në vitin 2022, 2,979 shtetas të huaj të cilët kanë emigruar në Kosovë për arsye punësimi kanë zëvendësuar më pak se 14% të fuqisë punëtore aktive që nuk ishin më pjesë e tregut të punës. Ngjashëm, edhe në vitin 2023, numri i shtetasve të huaj të cilët u pajisen me lejeqëndrim të përkohshëm në Kosovë ishte vetëm 5,570, ku 2,778 prej tyre ishin për arsye punësimi.

Në dhjetor 2023, Instituti GAP zhvilloi një anketë për të matur prirjet e qytetarëve për të emigruar qysh në pjesën e parë të vitit 2024. Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 28% e qytetarëve të Kosovës mbi 18 vjeç planifikojnë të emigrojnë në këtë periudhë. Kjo shifër del të jetë më e ulët se matjet e bëra më herët nga organizata të ndryshme, sikurse në vitet 2007 (mbi 30%), 2012 (34%), 2014 (43%), dhe 2018 (59%). Grup-mosha nën 24 vjeç përbën kategorinë më të prirur (33.4%) për të emigruar. Bazuar në evidencën nga vitet e mëhershme, ndonëse kjo prirje për të emigruar në vitin 2024 nuk pritet të realizohet brenda vitit, ajo tregon se tendenca për të emigruar mbetet e lartë. Liberalizimi i vizave mund të ketë një efekt shtesë në këtë drejtim krahasuar me vitet e kaluara, kur jo më shumë se 4.1% e popullsisë së Kosovës kishin emigruar brenda një viti.

Sektorët që pritet të preken në masë më të madhe nga largimi i punonjësve në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme janë ata të sektorit të ndërtimtarisë (18.7%), hotelarisë dhe gastronomisë (18.7%), tregtisë (18.1%) dhe prodhimit (12.9%). Të njëjtit janë ndër sektorët me numrin më të lartë të të punësuarve dhe ku produktiviteti i punonjësve është i lartë, mirëpo ku pagat vazhdojnë të mbesin të ulëta. Nga shqyrtimi i literaturës për përvojat e vendeve tjera dhe shkallës së zëvendësimit të punonjësve nga sektorë të caktuar që kanë emigruar me punonjës nga shtete tjera, në rast se nuk aktivizohet një pjesë e theksuar e popullsisë në moshë pune të cilët për momentin nuk janë duke kërkuar punë, në këta sektorë pritet rritje më e theksuar e pagave krahasuar me sektorët tjerë. Në vitin 2023 vërehet të ketë pasur ndryshim të pagave në tregun e punës në Kosovë, ku rreth 27.4% e të punësuarve të anketuar kanë raportuar rritje të pagave.

Rreth 45% e të anketuarve ishin të punësuar me punë të rregullt (39.3% të punësuar në sektorin privat dhe 5.8% në sektorin publik). Arsyet ekonomike dalin të jenë mbizotëruese në marrjen e vendimit për të emigruar. Mbi 20% e personave që planifikojnë të emigrojnë kanë realizuar të hyra në muajin e fundit prej 301-450 euro, ndërkaq 32.9% nuk kanë realizuar fare të hyra. Shumica e qytetarëve që planifikojnë të emigrojnë janë persona që kanë të përfunduar vetëm shkollimin e mesëm (57.7%). Destinacionet kryesore të qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë janë Gjermania me 71.4%; ndjekur nga Zvicra me 11.7%; dhe Austria me 5.3%.

Hyrje

Viteve të fundit, Kosova dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor po përballen me një shkallë të lartë të emigrimit të qytetarëve. Lëvizja e kësaj vale të emigrimit është duke shkaktuar transformime në strukturën demografike të këtyre vendeve, duke i privuar ato nga një pjesë e rëndësishme e fuqisë punëtore, duke ndikuar në sektorin e financave publike dhe duke ulur nivelet e kualitetit të jetës. Kjo gjithashtu ka implikime në perspektivën e zhvillimit afatgjatë ekonomik të këtyre shteteve.¹ Një ndër sfidat më direkte të emigrimit është ndryshimi në strukturën e fuqisë punëtore dhe ndikimi i këtij ndryshimi në ekonominë e shteteve të origjinës. Përpos ndikimit në tregun e punës dhe strukturën demografike brenda Ballkanit Perëndimor, emigrimi paraqet gjithashtu një lidhje të ndërlikuar me strukturën ekonomike dhe shoqërore të BE-së.²

Në dhjetor të vitit 2009, BE-ja lejoi udhëtimin pa viza për shtetasit e Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut; ndërsa, në fund të vitit 2010, këtë e bëri për Shqipërinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën.³ Kosova është shteti i fundit në rajon, qytetarët e të cilit mund të udhëtojnë pa viza në BE nga 1 janari 2024.⁴ Kosova ka një histori të gjatë të largimit të qytetarëve të saj, histori e cila ka kaluar në faza të ndryshme.⁵ Ndonëse në vitet e para të liberalizimit të vizave në vendet e rajonit, nuk është vërejtur një ndikim i dukshëm në lëvizjen e fuqisë punëtore, ky liberalizim i vizave e gjen Kosovën në rrethana ku fuqia punëtore veçse është duke emigruar në shkallë të konsiderueshme.⁶

Sipas të dhënave të ASK-së, nga viti 2012 deri në vitin 2022, nga Kosova kanë emigruar gjithsej 338,068 persona apo 18.8% e popullsisë së Kosovës. Në të njëjtën periudhë, në Kosovë kanë imigruar 91,806 persona, që i bie se migrimi neto për këto vite është 246,262 persona. Numri më i lartë i largimit të qytetarëve të Kosovës u shënuar në vitin 2015, ku 74,434 persona u larguan nga Kosova. I njëjti vit shënoi edhe kthimin më të madh, kur 18,862 persona u kthyen në Kosovë. Migrimi neto në këtë vit mbetet më i larti në një dekadë, një bilanc negativ i largimit të qytetarëve për 55,572 persona.⁷ Largimi i kosovarëve në këtë periudhë kontribuoi në thellimin e krizës së migrimit në shtetet e Bashkimit Evropian. Ky largim karakterizohet kryesisht si lëvizje ilegale e popullsisë, dhe si i tillë, u krye përmes rrugëve tokësore të cilat e lidhin Kosovën me shtetet perëndimore të Evropës. Vetëm Gjermania deklaroi se mbi 20 mijë persona nga Kosova kishin arritur në territorin gjerman në tremujorin e parë të vitit 2015. Arsyet e kësaj lëvizje ishin kryesisht pesimizmi kolektiv i shkaktuar nga situata e rëndë ekonomike në vend dhe jo-stabiliteti politik.⁸ Informacionet e pasakta se Gjermania do të pranojë kërkesat për azil-kërkim gjatë këtyre muajve, lehtësimi i kalimit të kufirit në mes të Serbisë dhe Hungarisë si shkak i një ndryshimi në ligjin e azilit në legjislacionin e BE-së, ishin disa nga faktorët të cilët ndikuan në këtë largim të qytetarëve të Kosovës drejt BE-së.⁹

1 Małgorzata, Walerych. [Efektet ekonomike të emigrimit: rishikim i literaturës. 2020](#); Icoski, Marjan. [Drejt një paradigme të re të ikjes së trurit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor](#), GMF, 2022.

2 Po aty.

3 Sqarim: Në çdo rast ku përmendet Bashkimi Evropian në këtë raport, i referohet edhe shteteve si Zvicra dhe Norvegjia të cilat nuk janë pjesë e BE-së por janë pjesë e lëvizjes së lirë të zonës Schengen.

4 Komisioni Evropian. [Pyetje dhe përgjigje – Raporti i pestë mbi regjimin pa viza të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit Lindor](#), 2022

5 Komisioni Evropian. [Migrimi dhe çështjet e brendshme](#).

6 Kotorri, Mrika. [Një hetim mbi migracionin ekonomik me referencë të veçantë për Kosovën](#), 2011

7 Banka Botërore, [Tendi i tregut të punës në Ballkanin Perëndimor 2020](#)


8 Agjencia e Statistikave të Kosovës, raportet e vlerësimit të popullsisë, 2012–2022.

9 Instituti Leibniz për Zhvillim Bujqësor në Ekonomitë në Tranzicion (IAMO), [Eksodi Kosovar: Si një shtet në ndërtim po humbet shtetasit e tij](#), 2015

9 Po aty.

Në vitet në vazhdim, me theks më të veçantë nga viti 2018, emigrimi i rregullt drejt vendeve të BE-së ka tejkaluar migrimin e parregullt të viteteve paraprake.¹⁰ Sipas të dhënave më të fundit të vitit 2022, nga Kosova u larguan 41,553 qytetarë, ndërsa 10,665 imigruan drejt Kosovës. Migrimi neto në vitin 2022 ishte 30,889 qytetarë.

Figura 1. Migrimi në Kosovë 2012 – 2022



Burimi: ASK

Emigrimi i fuqisë punëtore prek shumicën e vendeve të botës dhe paraqet një çështje e cila renditet lart në agjendat e politikave ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.¹¹ Kur qytetarët të cilët janë pjesë e fuqisë punëtore largohen nga vendi i tyre, shkaktojnë rënie në anën e ofertës në tregun e punës.¹² Mënyra se si kjo rënie në ofertën e punës ndikon në ekonominë e një vendi paraqet sfidë të madhe për qeveritë e vendeve të origjinës së emigrantëve, gjë e cila reflektohet në raste të ndryshme të shteteve të cilat janë përballur me nivele të larta të emigrimit.¹³

Ndikimet që sjellë emigrimi i qytetarëve në tregun e punës në ekonominë vendase (dërguese), sipas studimeve, janë të numërta. Në periudhën afatshkurtër, emigrimi i punonjësve krijon mungesë të punonjësve në treg dhe ndikon në rritje të pagave për punonjësit e mbetur që kanë shkathtësi të ngjashme me personat që kanë emigruar. Në rast që emigrojnë shumë mjekë nga një shtet, rritet kërkesa për mjekët që nuk kanë emigruar, dhe rrjedhimisht rriten edhe pagat e tyre. Por, për disa profesione të cilat janë plotësuese të profesioneve tjera, emigrimi mund të sjellë rënie të pagave. Konkretisht, me më pak mjekë në sektorin e shëndetësisë, bie kërkesa për shërbimet e ndihmësve medicinal, që mund të sjellë në ulje të pagave për këtë kategori. Në periudhën afatgjatë, nëse nga vendi emigrojnë kuadrot më të shkolluara, produktive dhe ndërmarrëse, ulet produktiviteti i tërësishëm në ekonomi, duke ndikuar kështu në rënie e gjithmbarshme të pagave në vend. Një efekt i tillë ishte dokumentuar Itali. Ngjashëm, nëse sektorët ku shkalla e emigrimit të punonjësve është e lartë

¹⁰ Ministria e Punëve të Brendshme, Profili i lehte i migrimit, 2021

¹¹ Zyra Ndërkombëtare e Punës. [Migrimi ndërkombëtar për çështje punësimi](#), 2010

¹² Louka T. Katseli et al. [Efektet e migrimit në vendet dërguese: Cfarë dimë ne?](#)

¹³ Po aty.

fuqia punëtore është faktor intensiv në prodhim, atëherë kjo mund të ndikojë që gradualisht struktura ekonomike të orientohet në sektorë ku kapitali apo makineritë janë faktor kyç në prodhim.¹⁴

Në rastin e shtetit të Meksikës, i cilit njëherit është një prej burimeve kryesore të migrantëve ndërkombëtar, emigrimi ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në strukturën ekonomike në vend.¹⁵ Flukset e mëdha të emigrimit e kanë zvogëluar fuqinë punëtore në vend dhe si pasojë, në nivel të pagave, llogaritet se 10% rënie në fuqinë punëtore në Meksikë ka ndikuar në rritje të pagës mesatare të atij grupi të punëtorëve me rreth 4%.¹⁶ Por, ndikimi ndryshoi në mes të grupeve të ndryshme të edukimit, ku punëtorë me kualifikime të ulëta, pavarësisht shkallës së lartë të emigrimit, pësuan rënie të pagave relative.¹⁷ Studime tjera tregojnë se disa nga vendet të cilat u përballen me shkallë të lartë të emigrimit, si Jemeni e Pakistani, pësuan rritje të pagave në sektorët të cilët ishin më të rrezikuar nga emigrimi.¹⁸ Në Pakistan, largimi në masë të madhe nga sektori i ndërtimit rezultoi në rritje të lartë të pagave në atë sektor.¹⁹ Ngjashëm, në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, shkalla e lartë e emigrimit ndonëse ndikoi në rritje të pagave, negativisht ndikoi në zhvillimin ekonomik të këtyre shteteve, duke ulur produktivitetin në këtë rajon.²⁰

Në Lituani, shumica e personave që kanë emigruar ishin të grupmoshës 20–30 vjeç, dhe rritja e pagave në vend për personat që nuk kishin migruar ndodhi pikërisht për këtë kategori, dhe jo edhe për personat më në moshë. Emigrimi në këtë shtet kishte ndikuar në rritje të pagave të rinjeve deri në 15%. Tendencë e njëjtë që pagat në ekonominë vendase të rriten vetëm për kategoritë me veçori të njëjta me popullsinë që kishte emigruar vërehet edhe në Poloni, ku pagat ishin rritur vetëm për kategorinë e qytetarëve me shkathtësi mesatare, dhe jo edhe për ata me shkathtësi të larta apo ulëta. Normalisht, ky ndikim në paga për këto kategori në fuqinë punëtore vendase ndikohet në masë të madhe nga shkalla e zëvendësimit të popullsisë që ka emigruar nga imigrantë të shteteve tjera, që mund ta neutralizojë këtë ndikim.²¹ Gjithsesi, emigrimi mund të ketë edhe një efekt pozitiv në ekonominë vendase në rastet kur emigrantët transferojnë dijen e fituar, investojnë në krijimin e bizneseve, etj.

Përmes këtij raporti, Instituti GAP synon të analizojë se si ndikon emigrimi i theksuar i qytetarëve të Kosovës në tregun e saj të punës duke vlerësuar zhvillimet në fuqinë punëtore në tregun e punës në Kosovë, duke llogaritur shifra aktuale të emigrimit të kosovarëve dhe shqyrtuar gjetjet e hulumtimeve mbi ndikimin e emigrimit në ekonominë e shteteve të rajonit që kanë përjetuar shkallë të lartë të emigrimit. Përveç shqyrtimit të literaturës, të dhënat kryesore përfshijnë rezultatet e anketës së matjes së opinionit publik të realizuar nga Instituti GAP gjatë muajit dhjetor 2023 në lidhje me planet dhe tendencën e qytetarëve të Kosovës për të emigruar pas liberalizimit të vizave, si dhe të dhënat nga agjencitë shtetërore të statistikave në vende të BE-së dhe vende të Ballkanit Perëndimor, të cilat GAP i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në të dhëna publike.

14 Elsner, Benjamin. [A rrit emigrimi pagat në vende dërguese të atyre që nuk emigrojnë?](#)

15 14.6% prej vitit 1980–2000. Po aty.

16 Aguila, E , et al. [Efektet e migrimit në shtetet e origjinës dhe destinacionit](#). 2012

17 Po aty.

18 Beth J. Asch. [Emigrimi dhe efektet e tij në shtetet dërguese](#).

19 Po aty.


20 Analiza empirike sugjeron se në vitin 2012, rritja kumulative e PBB-së reale do të kishte qenë mesatarisht 7 pikë përqindjeje më e lartë në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore në mungesë të emigrimit gjatë viteve 1995–2012. Ky përfshin Turqinë, Republikën Çeke, Hungarinë, Poloninë, Republikën Sllovaqe, Slloveninë, Bullgarinë, Kroacinë, Rumaninë, Shqipërinë, Bosnjen dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë, Estoninë, Letoninë, Lituanië, Bjellorusinë, Moldavinë, Federatën Ruse, dhe Ukrainës. IMF: [Parashikimi Ekonomik Rajonal: CESEE](#)

21 Elsner, Benjamin. [A rrit emigrimi pagat në vende dërguese të atyre që nuk emigrojnë?](#)

Tregu aktual i punës në Kosovë

Pavarësisht rritjes ekonomike dhe klimës së përmirësuar të biznesit, treguesit e tregut të punës në Kosovë janë ndër më e dobëtit në rajon dhe në Evropë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, papunësia në Kosovë llogaritet 11.8%, pjesëmarrja në fuqinë punëtore aktive është vetëm 38.5% krahasuar me 61.5% të shkallës së popullsisë të cilët i takojnë moshës së punës por janë ekonomikisht jo-aktiv.²² Përkatësisht, nga gjithsej 1,195,426 persona të cilët i takojnë moshës së punës, vetëm 461,894 janë aktiv në fuqinë punëtore (403,813 të punësuar, dhe 58,081 të papunësuar) dhe 733,532 janë ekonomikisht jo-aktiv. Sipas raporteve të Bankës Botërore, rritja e punësimit në Kosovë kufizohet nga baza e pamjafueshme e kapitalit njerëzor, fuqia punëtore e paarsimuar dhe e aftësuar në mënyrë të pamjaftueshme.²³

Figura 2. Fuqia punëtore aktive dhe jo-aktive në Kosovë



Burimi: ASK

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore jo-aktive tejkalon pjesëmarrjen në fuqinë punëtore aktive për çdo vit me radhë (2018–2022). Në kategorinë e fuqisë punëtore aktive bëjnë pjesë të punësuarit dhe të papunësuarit.²⁴ Nëse e krahasojmë trendin e viteve të fundit, vërehen lëvizje në pjesëmarrjen gjithsej në fuqi punëtore. Si rrjedhojë, vetëm sipas dallimit në mes të vitit 2021 me vitin 2022, llogaritet se:

- Fuqia punëtore aktive është zvogëluar për 21,571 persona
- Fuqia punëtore jo-aktive është zvogëluar për 14,698 persona

Ky zvogëlim i fuqisë punëtore jo-aktive nuk rezulton në rritje të fuqisë punëtore aktive. Ndonëse ndryshimet e fuqisë punëtore ndikohen nga faktorë të ndryshëm social, ekonomik, dhe demografik, emigrimi mbetet çështje mjaft sfiduese për këto ndryshime të lëvizjës së fuqisë punëtore në Kosovë.

Në kuadër të fuqisë punëtore aktive, pjesëmarrja e burrave është konsiderueshëm më e lartë se e grave, ku gjithsej 329,469 (71%) burra janë aktiv në fuqinë punëtore krahasuar me 132,425 (29%) gra. Ky dominim gjinor vërehet edhe tek të punësuarit dhe të papunësuarit. Dallimi poashtu i madh është edhe në

²² Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Tregu i Punës](#).


²³ Komisioni Evropian, [IPA II 2014–2020, Kosovë, Punësimi dhe Arsimi](#).

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Tregu i Punës](#), 2022

pjesëmarrjen jo-aktive të burrave dhe grave në fuqinë punëtore. Të kjo kategori kemi 264,056 (36%) burra dhe 469,476 (64%) gra. Inaktiviteti sugjeron që këta persona janë duke u shkolluar/trajnuar, apo thjeshtë nuk janë duke kërkuar punë.

Një 'ndikim pozitiv' i migrimit në ekonominë vendase mendohet të jetë ai i uljes së numrit të personave jo-aktiv në tregun e punës. Duke u përballur me mungesë të fuqisë punëtore, bizneset janë të detyruara të rrisin pagat, të ofrojnë fleksibilitet më të madh në orarin e punës etj. Në rastin e Kosovës, ndikimi mund të jetë edhe më i theksuar tek gratë, të cilat kanë një shkallë tejet të ulët të pjesëmarrjes në fuqinë aktive në tregun e punës. Të dhënat tregojnë se përgjatë viteve 2012-2019, emigrimi i qytetarëve të Ballkanit Perëndimor ndryshoi pjesëmarrjen në fuqinë punëtore në këto vende, duke ndikuar në rritje të shkallës së aktivitetit në fuqinë punëtore për 4.5 pikë të përqindjes. Kjo erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së grave në nivel rajonal në fuqinë punëtore aktive. Rritje më e lartë se mesatarja u shënuar në Mal të Zi (8 pikë të përqindjes), në Serbi (6.6 pikë të përqindjes), dhe Shqipëri (4.9 pikë të përqindjes), ndërsa në shtetet e tjera u rrit me 2 pikë të përqindjes ose më pak.²⁵

Figura 3. Fuqia punëtore aktive dhe jo-aktive në Kosovë sipas gjinisë



Burimi: ASK

Sektorët ekonomikë në të cilët është i përqendruar punësimi tregojnë një tjetër aspekt të rëndësishëm të tregut të punës në Kosovë. Prodhimtaria ka tejkaluar ndërtimtarinë si punëdhënësi i dytë më i madh, duke punësuar 12% të atyre që aktualisht janë të punësuar. Ndërtimtaria punëson 11%, ndjekur nga arsimiti me 10% dhe administrata publike me 7%.²⁶ Sipas rezultateve të anketës, të shtjelluara më poshtë, ndikimi që emigrimi do të ketë në sektorin e ndërtimtarisë është i lartë, me 18.7% të të punësuarve të cilët planifikojnë të emigrojnë, si dhe prodhimit me 12.9%.

Të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se kriza e mungesës së punëtorëve është një nga shqetësimet më të mëdha në të gjithë Ballkanin Perëndimor.²⁷ Shifrat e larta të emigrimit nga Kosova (41,553 në 2022) dhe bilanci i lartë i migrimit negativ, se bashku me tkurrjen e fuqisë punëtore aktive, janë faktorë mjaft sfidues për Kosovën. Supozimi se fuqia punëtore aktive, kryesisht të rinjtë, janë duke u larguar nga Kosova, pa dyshim që krijon hendek të pazëvendësueshëm në tregun e punës në Kosovë. Për vite me radhë, në kërkim të mbushjes së zbrazëtisë e cila krijohet nga emigrimi, bizneset kosovare janë munduar të tërheqin fuqi punëtore nga vende tjera brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit Perëndimor.²⁸

25 Banka Botërore. [Trendet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor](#), 2020

26 Friedrich Ebert Stiftung. [Pamje e madhe; një agjendë progresive ekonomike për Kosovën](#), 2021

27 Banka Botërore. [Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor; drejt rritjes së qëndrueshme](#), 2023

28 Organizata Ndërkombëtare për Migrim, [Liberalizimi i vizave: mundësi e artë për Kosovën](#), 2023

Imigrantët të cilët pajisen me lejeqëndrime në Kosovë nuk e zgjidhin problemin e mungesës së fuqisë punëtore. Sipas të dhënave më të fundit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë (janar-nëntor 2023), numri i personave të huaj të cilët u pajisen me leje-qëndrime të përkohshme në Kosovë ishte 5,570, prej tyre, 2,778 për arsye të punësimit. Në vitin paraprak, numri i personave të cilët u pajisen me leje-qëndrime ishte 6,244, nga ta, 2,979 për qëllime të punësimit (për të dhëna të detajuara për vitet 2021-2023, shih tabelën 3.1 dhe 3.2 në shtojca). Shumica e imigrantëve në Kosovë janë me origjinë nga shtetet e rajonit si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, dhe vendet jashtë rajonit si Turqia, Bangladeshi dhe shtetet tjera të Azisë. Aktualisht këta imigrantë, krahasuar me numrin e emigrantëve kosovarë të cilët largohen nga Kosova drejt shteteve të BE-së, janë në numër mjaft të vogël dhe nuk arrijnë të zëvendësojnë pjesën e munguar të fuqisë punëtore në tregun e punës.

Tabela 1. Leje-qëndrimet e përkohshme për shtetasit e huaj në Kosovë (2023)

2023	Gjithsej	Bashkim familjar	Punësim	Studime	Humanitare	Tjera
Turqia	1,503	33	896	203	46	5
Serbia	1,156	560	416	167	1	12
Shqipëria	1,009	563	414	23	1	8
Maqedonia e Veriut	548	338	195	11	0	4
Bangladeshi	168	2	166	0	0	0
SHBA	144	43	91	10	0	0
Mali i Zi	102	56	35	11	0	0
Gjermania	101	38	57	3	0	3
Filipinet	67	3	64	0	0	0
Zvicra	55	42	13	0	0	0
Britania e Madhe	39	15	24	0	0	0
Italia	39	7	31	1	0	0
Jordania	38	4	26	0	8	0
Ukraina	36	5	9	0	22	0
Polonia	34	2	32	0	0	0
Bosnja dhe Hercegovina	30	20	9	1	0	0
Tailanda	28	0	28	0	0	0
Franca	27	16	10	1	0	0
Nepali	25	0	25	0	0	0
Tjera	421	464	237	6	32	2
Gjithsej	5,570	2,211	2,778	437	110	34


Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

Prirja e qytetarëve të Kosovës për të emigruar në vitin 2024

Për të matur prirjen për migrim të qytetarëve, Instituti GAP ka kryer një hulumtim të opinionit publik në nivel vendi,²⁹ pra në 38 komuna të Kosovës, duke përdorur teknikën e "mostrës së shtresuar me përzgjedhje të rastësishme". Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1,066 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç, duke reflektuar në të edhe strukturën etnike në Kosovë dhe hulumtimi ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +/-3%. Hulumtimi në teren është zhvilluar nga data 14 deri më 21 dhjetor 2023.

Gjetjet kryesore të anketës në lidhje me tendencën e qytetarëve për të emigruar në tremujorin e parë të 2024 tregojnë se 27.9% e qytetarëve planifikojnë të emigrojnë drejt shteteve të zonës Schengen (janar-mars), 61.2% nuk kanë plane për të emigruar në këtë periudhë dhe 10.9% e tyre nuk kanë ndonjë plan specifik emigrimi. Sa i përket ndarjes gjinore, rreth 30% e burrave kanë plane për të emigruar në periudhën janar-mars 2024, krahasuar me 26% të grave.³⁰ Kjo shifër del të jetë më e ulët se matjet e bëra më herët, sikurse në vitet 2007 (mbi 30%), 2012 (34%), 2014 (43%) dhe 2018 (59%).³¹ Bazuar në evidencën nga vitet e mëhershme, ndonëse kjo prirje prej 27.9% të qytetarëve për të emigruar në pjesën e parë të vitit 2024 nuk pritet të realizohet brenda vitit, gjithsesi pasqyron tendencën e lartë për të emigruar.³² Edhe në vitet kur prirja e qytetarëve në Kosovë për të emigruar ishte e lartë, sikurse në vitin 2015, kur u regjistrua edhe numri më i madh i personave që kanë emigruar brenda vitit, jo më shumë se 4.1% e popullsisë kishte emigruar në atë vit. Por, krahasuar me vitet e mëhershme, një dallim në vitin 2024 mbetet liberalizimi i vizave, që u mundëson qytetarëve lëvizje të lirë dhe mundësi më të mëdha për të komunikuar me punëdhënës potencial në shtetet e huaja. Ngjashëm, arsye për këtë prirje më të ulët për të emigruar se në vitet e kaluara është fakti se tashmë një pjesë e theksuar e qytetarëve veçse kanë emigruar (mbi 338 mijë deri në vitin 2022).

Figura 4. Planifikimi i qytetarëve nga Kosova për të emigruar në tremujorin e parë të 2024 (nga 1,066 persona të anketuar)



²⁹ Duke kontraktuar kompaninë profesionale për matje të opinionit – UBO Consulting.


³⁰ Rreth 11% e burrave nuk e dinë se a do të emigrojnë apo jo, krahasuar me 10% të grave.

³¹ Kotorri, Mrika. [Një hetim mbi migracionin ekonomik me referencë të veçantë për Kosovën](#), f. 5-8, 2011; GLPS, [Migrimi 2.0, Kush janë kosovarët më të gatshëm për të migruar në vendet e BE-së? Analizë empirike](#), 2015; Beqiri, Theranda. et al., [Prirja e të rinjëve për të emigruar, dëshmi nga Kosova](#), 2022.

³² Po aty.

Për qytetarët të cilët kanë deklaruar se do të emigrojnë në tremujorin e parë të vitit 2024, destinacionet kryesore janë Gjermania me 71.4%; ndjekur nga Zvicra me 11.7%; dhe Austria me 5.3%.


Figura 5. Destinacionet kryesore të qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë



Gjithsej 28.2% e qytetarëve cilësuan mundësitë më të mira për punësim si arsyeja kryesore e cila i shtynë ata të planifikojnë emigrimin pas liberalizimit të vizave, ndjekur me përmirësimin e cilësisë së jetesës për veten dhe familjen (arsimi, shëndetësia, siguria, etj) me 26.3%, pagat më të larta me 22.4%, zhvillimi në karrierë me 14.1% dhe krijimi i familjes apo bashkimi familjar me 9%.

Shumica e qytetarëve të cilët deklaruan se planifikojnë të emigrojnë janë të rinjë. Nga ata të cilët kanë planifikuar të emigrojnë në tremujorin e parë të 2024, 33.4% i takojnë grup-moshës nën 24 vjeç, ndjekur nga rreth 31.4% që i takojnë grup-moshës 25-34 vjeç.

Figura 6. Grup-moshat e qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë




Sa i përket shkollimit dhe kualifikimeve të personave të cilët planifikojnë të emigrojnë, dominojnë studentët me 41%, ndjekur nga personat të cilët kanë përfunduar studimet bachelor me 31% dhe personat të cilët kanë të përfunduar shkollimin e mesëm me 30.5%. Te personat të cilët nuk kanë plane për të emigruar, përfshihen 80% të atyre të cilët nuk kanë fare edukim, ndjekur nga ata të cilët kanë përfunduar vetëm disa vite të shkollës fillore me 78.9%.

Planet për të emigruar përfshijnë 36.6% e të punësuarve në sektorin privat; 34.5% e të punësuarve kohë pas kohe; dhe 31.6% e të papunësuarve, por të cilët janë duke kërkuar punë. Për dallim, tendencë për të qëndruar në Kosovë kanë më shumë pensionistët ku 90.1% e të cilëve deklarojnë se nuk do të emigrojnë, dhe të punësuarit në sektorin publik prej të cilëve 72.8% nuk janë të prirur për të emigruar.

Sipas të dhënave të anketës, 32.9% e qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë i takojnë grupit të cilit nuk kanë realizuar fare të hyra në muajin dhjetor, ndjekur nga 21.8% të cilët pranuan të hyra prej 301–450 euro dhe 13.4% me të hyra personale mujore prej 451–600 euro.³³


Figura 7. Të hyrat mujore personale të qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë



Rreth 27.4% e të anketuarve të punësuar kanë pasur rritje të pagave gjatë vitit 2023, krahasuar me 64.5% të cilët nuk kanë pasur rritje të pagave gjatë kësaj kohe. Ndërkohë, 8.1% prej tyre deklarojnë se rritja e pagave i'u është premtuar për vitin 2024. Reagimi i bizneseve duke rritur pagat për punojësit është një nga masat që ndikon pozitivisht në uljen e tendencës për të emigruar, meqë gjetjet e Institutit GAP tregojnë se arsyet ekonomike mbesin nga indikatorët kyç në marrjen e vendimit për të emigruar. Po ashtu, edhe në sektorin publik, rritja e pagave përmes miratimit të Ligjit për pagat në sektorin publik në vitin 2023, dhe rritjes shtesë të pagave përmes rritjes së koeficientit të pagave në vitin 2024, mund të ketë efekt pozitiv në uljen e tendencës së punonjësve të sektorit publik për të emigruar.


³³ Nga këto kategori, personat të cilët refuzuan të përgjigjen përbëjnë 13.4%.

Figura 8. Ndryshimi/rritja e pagave për të punësuarit gjatë vitit 2023



Nga gjithsej qytetarët të cilët deklaruan se kanë pasur rritje të pagave në vitin 2023, 38.3% e tyre janë të punësuar në sektorin publik dhe 59% në sektorin privat. Te personat të cilët deklaruan se i'u është premtuar rritje e pagave për vitin 2024, të punësuar në sektorin publik janë 25% dhe të punësuar në sektorin privat janë 55% prej tyre.³⁴

Figura 9. Rritja e pagave për të punësuarit gjatë vitit 2023 në sektorin publik dhe privat



Pjesa më e madhe e qytetarëve të cilët deklaruan se do të emigrojnë në tremujorin e parë të vitit 2024, më saktësisht 18.7% e tyre punojnë në sektorin e ndërtimitarisë; 18.7% në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë; ndjekur nga 18.1% të cilët punojnë në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë. Në masë më të vogël, të anketuarit që kanë deklaruar se planifikojnë të emigrojnë janë nga sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit me 2.6% dhe transportit me 3.2%.

Duke krahasuar të dhënat e numrit të të punësuarve dhe produktivitetin e sektorëve ku ata punojnë, del se tendenca për të emigruar do të ndikojë më së shumti në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë i cili numëron afro 79 mijë të punësuar, sektorin e ndërtimitarisë i cili numëron rreth 45 mijë të punësuar, dhe sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë me mbi 31 mijë të punësuar. Të njëjtit janë ndër sektorët me numrin më të lartë të të punësuarve dhe ku produktiviti

³⁴ Pjesa tjetër janë të punësuar kohë pas kohe apo të vetëpunësuar.

i punonjësve është i lartë, mirëpo ku pagat vazhdojnë të mbesin të ulëta. Në vitin 2022, paga mesatare bruto në sektorët më të ndikuar ishte më e ulët se paga mesatare në vend. Konkretisht, në sektorin e gastronomisë paga mesatare bruto ishte 323 euro, në ndërtimtari 444 euro, në tregti 449 euro, prodhim 409 euro, etj. Disa nga sektorët të cilët do të ndikohen më së paku nga emigrimi janë sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit i cili njëherit ka produktivitetin më të lartë nga të gjithë sektorët por nga i cili vetëm 2.6% deklarojnë se do të emigrojnë. Ndërsa, disa sektorë tjerë të rëndësishëm si arsimit, shëndetësia, IT, do të ndikohen në masë më të vogël, prej të cilëve rreth 7% kanë deklaruar se kanë plane për të emigruar.


Tabela 2. Tabela 2. Prirja për emigrim nga sektorët kryesorë ekonomikë

Sektori	Të punësuar 2022	Produktiviteti (në euro) ³⁵	% që do të emigrojnë ³⁶	A keni pasur rritje page në 2023?
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	9,110	72,187	2.6%	15.8%
Prodhim	36,250	32,481	12.9%	22.4%
Ndërtimtari	45,015	16,912	18.7%	23.5%
Tregti me shumicë dhe pakicë	78,804	16,223	18.1%	18.1%
Aktivitetet hotelerie dhe shërbimesh ushqimi	31,542	10,427	18.7%	21.5%
Transport dhe depozitim	18,041	12,538	3.2%	20%
Informim dhe komunikim	10,089	17,669	6.5%	20.5%
Arsim	44,226	6,197	7.1%	58.7%
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	25,607	7,215	7.1%	48%
Aktivitetet e shërbimeve tjera	11,795	2,414	5.1%	34.6%

Burimi: ASK

Nga qytetarët të cilët jetojnë në zona urbane, rreth 27.7% e tyre do të emigrojnë në pjesën e parë të vitit 2024. Ndërsa, përqindja e atyre të cilët jetojnë në zona rurale e që planifikojnë të emigrojnë është 28.1%.

Figura 10. Ndarja e vendbanimeve urbane/rurale e qytetarëve të cilët planifikojnë të emigrojnë




³⁵ Produktiviteti i punës në Kosovë është llogaritur duke përdorur të dhënat e ASK-së për BPV-në dhe punësimin

³⁶ Llogaritja bazuar në anketën e realizuar nga Instituti GAP

Sipas të dhënave të anketës, disa nga arsyt kryesore të cilat do të motivonin qytetarët për të mos emigruar dhe qëndruar në Kosovë janë pagat më të mira (32.4%), përmirësimi i kushteve të punës sikurse respektimi i kontratës së punës, orarit të punës, pushimit vjetor dhe të ngjashme (29.2%), përmirësimi i gjendjes në shëndetësi (13.8%), etj.

Figura 11. Faktorët të cilët do të ndikonin për të mos emigruar



Kërkesat për punë në vendet e BE-së

Liria e lëvizjes së punëtorëve në BE është një ndër themelet kryesore të integritimit evropian në BE, e cila poashtu përfshin edhe lëvizjen e kapitalit, mallrave dhe shërbimeve.³⁷ Lëvizja e lirë e qytetarëve njëkohësisht paraqet një ndër çështjet më të ndjeshme dhe sfiduese të lirive në BE.³⁸ Kombinimi i faktorëve si popullsia me jetëgjatesi më të madhe dhe niveli i ulët i lindjeve ka ndikuar që popullsia e cila i takon fuqisë punëtore të Evropës, të jetë gjithnjë e në rënie. Sipas disa parashikimeve të Kombeve të Bashkuara, pritet që në vitin 2050, Evropa të ketë 95 milionë njerëz më pak të cilët i takojnë moshës së punës 15–64 vjeç, krahasuar me vitin 2020.³⁹ Zgjidhjet si përdorimi i teknologjisë për të zëvendësuar punëtorët dhe inkurajimi i lindjeve, nuk do të luajnë rol në parandalimin e krizës së fuqisë punëtore, dhe si pasojë, Evropa do të duhet të inkurajojë imigrimin nga vendet tjera, dhe/ose të eksportojojë punë.⁴⁰

Mungesa e fuqisë punëtore ekziston në sektorë dhe profesione të ndryshme nga të gjitha nivelet e aftësive. Sipas një raporti të Komisionit Evropian, mungesa e fuqisë punëtore do të vërehet edhe në sektorët të cilët kërkojnë aftësi, por edhe në ata sektorë të cilët konsiderohen me aftësi të ulëta. Sektorët më të prekur në 2022 ishin sektorët si ndërtimi, kujdesi shëndetësor, STEM (shkenca, teknologjia, inxhinieria dhe matematika), dhe TIK (Teknologjia e Informacionit

³⁷ Kahanec, Martin. [Lëvizja e fuqisë punëtore në një bashkim të zgjeruar evropian](#). Manual ndërkombëtar mbi ekonominë e migrimit. 2013

³⁸ Po aty.

³⁹ Kennz, Charles. Yang, George. [A mund ta ndihmojë Afrika Evropën të shmangë krizën e saj të plakjes?](#). Qendra për Zhvillim Global. 2021

⁴⁰ Po aty.

dhe Komunikimit).⁴¹ Si rrjedhojë, Komisioni Evropian promovon migrimin e targetuar të qytetarëve të shteteve jo-evropiane, për të ulur mungesën e fuqisë punëtore në sektorë të caktuar.⁴²

Shtetet e BE-së poashtu ofrojnë të ashtuquajturën 'Kartën Blu', e cila i mundëson personat e kualifikuar jashtë Bashkimit Evropian të pajisen me punë dhe leje-qëndrime në shtetet e BE-së nëse ata vërtetojnë që kanë kualifikime të larta (universitare).⁴³ Në përpjekje për të inkurajuar imigrimin, shtetet e BE-së kanë miratuar politika të ndryshme. Njëra nga këto shtete është Gjermania e cila prezantoi rrugë të ndryshme ligjore për të tërhequr fuqi punëtore të huaj, për të menaxhuar rënien demografike të saj dhe për të zvogëluar migrimin e parregullt. Në vitin 2015, Gjermania hapi tregun e punës për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor si përgjigje ndaj rregullores së re, e njohur si Rregullorja e Ballkanit Perëndimor (RRBP),⁴⁴ e cila nuk specifikoi ndonjë kusht për ndonjë shkathtësi të caktuar, e si rrjedhojë, i ftonte të dyja kategoritë e punëtorëve -të kualifikuar dhe të pa kualifikuar- në tregun gjerman të punës mbi bazën e një oferte të vlefshme pune.⁴⁵

Këto rregullore kanë ndikuar që emigrimi nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të rritet për 120% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2010. Trendi i emigrimit ka pësuar rritje edhe para pandemisë Covid-19, posaçërisht prej vitit 2015.⁴⁶ Më shumë se 25% e popullsisë së lindur në Ballkanin Perëndimor (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Serbi, Mal i Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë) jeton jashtë këtij rajoni. Kosova, ndër këto shtete, radhitet e dyta sa i përket numrit të qytetarëve të cilët jetojnë jashtë saj.⁴⁷

Historia e emigrimit të kosovarëve është e gjatë, mjaft komplekse, dhe ende vazhdon të jetë sfiduese për vendin. Destinacionet kryesore të qytetarëve të Kosovës, ndër vite, kanë qenë Gjermania, Zvicra dhe Austria.⁴⁸ Në Gjermani jetojnë 542 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova.⁴⁹ Kjo si rezultat i migrimit drejt Gjermanisë i cili filloi në mesin e viteve 1960 e që po vazhdon edhe aktualisht.⁵⁰ Të dhënat e fundit nga zyrat federale të statistikave të Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Belgjikës dhe Kroacisë tregojnë se në vitin 2022, migrimi neto i kosovarëve në Gjermani ishte ekuivalent me 17,383; në Zvicër 1,735; në Austri 751, në Belgjikë 349; dhe në Kroaci 912 (për të dhëna të plota të imigrimit dhe emigrimit të kosovarëve në këto shtete në periudhën 2019 – 2022 shih tabelën 1; 1.2; 1.3; 1.4; dhe 1.5 në shtojca).

41 Komisioni Evropian. [Raporti i Komisionit konstaton se mungesat e fuqisë punëtore dhe të aftësive vazhdojnë dhe shqyrton mënyrat e mundshme për t'i trajtuar ato](#). 2023

42 Po aty.

43 Komisioni Evropian. [Karta Blu, Informacionet Kryesore](#).

44 Kjo rregullore është e parashikuar në nenin 26.2 të Urdhëresës së Punësimit (Beschäftigungsverordnung). Jessica Bither, Astrid Ziebarth. [Krijimi i rrugëve ligjore për reduktimin e migrimit të parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga "Rregullorja për Ballkanin Perëndimor" e Gjermanisë](#). Grupi i Strategjisë së Migracionit mbi Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar. 2018

45 Instituti GAP, [Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani](#). 2020


46 OBZHE, [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Hartimi i modeleve, adresimi i sfidave dhe mbledhja e përfitimeve](#). 2022

47 Po aty.

48 OBZHE, [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Hartimi i modeleve, adresimi i sfidave dhe mbledhja e përfitimeve](#), p.25, 2022.

49 Instituti GAP. [Migrimi i kosovarëve në Gjermani: Analizë statistikore](#). 2023

50 Po aty.

Figura 12. Migrimi neto i kosovarëve në BE (2019 – 2022)

Burimi: Agjencitë Zyrtare të Statistikave të Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Belgjikës dhe Kroacisë

Trendi i emigrimit në Ballkanin Përëndimor pas liberalizimit të vizave

Bashkimi Evropian çdo vit pranon mesatarisht 2 milionë deri në 2.5 milionë imigrantë nga shtetet jashtë BE-së.⁵¹ Në vitin 2022, mosha mesatare e popullsisë së Evropës ishte 45.4 vjeç, ndërsa mosha mesatare e popullsisë imigrante ishte 36.6 vjeç.⁵² Sipas të dhënave të fundit, 23.8 milionë banorë të shteteve jo-evropiane aktualisht jetojnë në shtetet e Bashkimit Evropian, duke përbërë 5.3% të gjithë popullsisë.⁵³

Bashkimi Evropian, në vitin 2022 lëshoi 3.7 milionë leje-qëndrime për herë të parë për shtetasit jashtë Bashkimit Evropian.⁵⁴ Njëherit, kjo paraqet shifrën më të lartë që nga viti 2009. Punësimi është arsyeja kryesore prapa këtyre leje-qëndrimeve, ndjekur nga bashkimi familjar. Sipas të dhënave të Eurostat-it, nga shtetet e Ballkanit Përëndimor, leje-qëndrimet në BE për qytetarët e Shqipërisë të lëshuara në vitin 2022 paraqesin shifrën më të lartë, gjithsej 76,491; ndjekur nga Serbia me 69,428; Bosnja dhe Hercegovina me 47,870; Maqedonia e Veriut me 27,647; Kosova me 23,036; dhe Mali i Zi me 3,835 leje-qëndrime për herë të parë në BE.⁵⁵

Në periudhën 2010–2022, në shtetet e BE-së, janë lëshuar gjithsej 652,993 leje-qëndrimi për herë të parë për shtetasit e Shqipërisë, ekuivalent me 22.76% të popullsisë së Shqipërisë. Vetëm në vitet e fundit, përkatësisht në periudhën 2018–2022, numri gjithsej i leje-qëndrimeve për shtetasit shqiptarë llogaritet

51 Sipas të dhënave të fundit, në vitin 2021 në BE imigruan 2.3 milionë rezident të shteteve jashtë BE-së. Eurostat. [Statistikat e migrimit dhe popullsisë së migrimit.](#)

52 Po aty.

53 Në terma absolut, numri më i madh i qytetarëve jashtë BE-së të cilët jetojnë në shtete të BE-së janë të vendosur në Gjermani (10.9 milionë), Spanjë (5.4 milionë), Francë (5.3 milionë) dhe Itali (5 milionë). Po aty.

54 Gjermania dominon dukshëm në numrin më të madh të lejeve të lëshuara në 2022, me gjithsej 538,690 leje. Po aty.

55 Eurostat. Leje-qëndrimet e para sipas arsyes, kohëzgjatjes së vlefshmërisë dhe shtetësisë. 2022.

290,916 apo 44% e totalit nga 2010–2022. Destinacionet kryesore janë Italia, Greqia dhe Gjermania (shih tabelën 2.2 në shtojca).

Për të njëjtën periudhë, gjithsej 477,634 qytetarë të Serbisë janë pajisur me leje-qëndrime në shtetet e BE-së. Përqëndrimi më i madh evidentohet në vitet 2018–2022 me gjithsej 268,059 leje, apo 56% e totalit (shih tabelën 2.4 në shtojca). Destinacionet kryesore të qytetarëve serb janë Gjermania dhe Kroacia.


Nga Bosnja dhe Hercegovina, në periudhën 2010–2022, shtetet e BE-së kanë lëshuar gjithsej 379,853 leje-qëndrime. Trendi më i lartë i rritjes vërehet nga viti 2018 deri 2022, ku sipas të dhënave zyrtare të Eurostat, në këtë periudhë janë pajisur me leje-qëndrime gjithsej 226,337 qytetarë të Bosnjës dhe Hercegovinës, apo 59.5% krahasuar me totalin nga viti 2010. Destinacionet kryesore janë Gjermania, Sllovenia dhe Kroacia (shih tabelën 2.6 në shtojca).

Leje-qëndrimet e lëshuara për herë të parë në shtetet e BE-së për qytetarët e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2010–2022 arrijnë numrin 202,504. Ngjashëm me trendin në shtete tjera të rajonit, vërehet rritje në vitet e fundit, ku vetëm për periudhën 2018–2022 janë lëshuar 109,157 leje-qëndrime, apo 53.9% e totalit nga 2010. Destinacionet kryesore janë Gjermania dhe Kroacia (shih tabelën 2.3 në shtojca).

Kosova, e cila është vendi fundit në Ballkanin Perëndimor që është bërë pjesë e lëvizjes së lirë pa viza në zonën Schengen, gjithsesi sfidohet nga numri i lartë i emigrimit të qytetarëve të saj. Nga viti 2010, 301,624 kosovarë janë pajisur me leje-qëndrime për herë të parë nga shtetet e BE-së. Numri më i madh i leje-qëndrimeve prej 153,708 apo 50% e totalit, evidentohet në periudhën 2018–2022. Destinacionet kryesore për këtë periudhë janë Gjermania dhe Sllovenia (shih tabelën 2.1 në shtojca).

Mali i Zi paraqet shtetin me numrin më të vogël të qytetarëve të cilët janë pajisur me leje-qëndrime në shtetet e BE-së, me vetëm 28,492 leje-qëndrime. Prej tyre 15,768 apo 55% janë lëshuar në periudhën 2018–2022. Destinacionet kryesore janë Gjermania dhe Kroacia (shih tabelën 2.5 në shtojca).


Figura 13. Trendi i leje-qëndrimeve për herë të parë në BE (2010–2022)



Bazuar në të dhënat e pajisjeve me leje-qëndrime në shtetet e destinacioneve të emigrantëve me origjinë nga Ballkani Perëndimor, në raport me popullsinë e këtyre të fundit, në periudhën 2010–2022, del se 22.7% e popullsisë së Shqipërisë ka emigruar; 15.1% e popullsisë së Kosovës; 11.1% e popullsisë së Bosnjës dhe Hercegovinës; 10% e popullsisë së Maqedonisë së Veriut; 6.2% e popullsisë së Serbisë; dhe 4.3% e popullsisë së Malit të Zi.

Figura 14. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE

Numri i leje-qëndrimeve për herë të parë në BE/
Raporti me gjithsej popullsinë



gapo

Burimi: Eurostat

Sipas të dhënave zyrtare, në vitet e para të liberalizimit i vizave për shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk është evidentuar emigrim i lartë nga këto të fundit.⁵⁶ Që nga liberalizimi i vizave (2009–2010) deri në vitin 2014, lëvizjet e popullsisë drejt shteteve të zonës Schengen ishin kryesisht stabile. Ishte viti 2015 i cili shënoi pikën më të lartë të emigrimit nga shtetet e Ballkanit Perëndimor në shtetet e BE-së. Në këtë vit, bashkë me refugjatët sirianë të cilët e shfrytëzonin Gadishullin Ballkanik si tranzit për të kërkuar azil në shtetet e BE-së, qytetarët e rajonit të Ballkanit Perëndimor poashtu shfrytëzuan të njejtën mundësi për tu larguar.⁵⁷ Ky emigrim ishte kryesisht ilegal. Pas vitit 2015, reformat në politika të migrimit në BE rregulluan lëvizjen e qytetarëve drejt tyre, duke kontribuar në zvogëlim të migrimit ilegal.⁵⁸

Qytetarët e Shqipërisë para liberalizimit të vizave me BE-në, ishin me pak të prirur për të udhëtuar për arsye të punë-kërkimit, ndërsa, liberalizimi i vizave i mundësojë atyre të udhëtonin lirshëm, të eksploronin tregun e punës në vendet e destinacionit dhe të ktheheshin pa e rrezikuar mundësinë e tyre që prapë të udhëtonin në Evropë në muajt vijues në kërkim të punës.⁵⁹ Studimet tregojnë se në vitin e parë të implementimit të lëvizjes së lirë pa viza nuk ka pasur abuzime masive të qëndrimit jashtë periudhës kohore të përcaktuar me rregullore të Komisionit Evropian.⁶⁰ Për më tepër, numri i personave të cilët e kanë tejkaluar

⁵⁶ Komisioni Evropian. [Politikat e vizave](#), f.28.

⁵⁷ OBZHE. [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Modelet e hartës, Adresimi i Sfidave dhe korrja e përfitimeve](#), f. 30, 2022.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Dynes, Laurence. [Ndikimi i Liberalizimit të Vizave të BE-së në Ballkanin Perëndimor](#), 2022

⁶⁰ Sipas rregulloreve të Komisionit Evropian për lëvizje të lirë në zonën Schengen, qëndrimi nuk duhet të kalojë periudhën prej 90 ditësh brenda 180 ditëve. Komisioni Evropian, [Liberalizimi i vizave: Komisioni raporton mbi](#)

gapo

afatin kohor të qëndrimit në BE nuk ndryshon nga periudha e mëhershme para liberalizimit të vizave.⁶¹

Një studim i publikuar në vitin 2017 tregon se 20% e ligjërueseve, asistentëve dhe hulumtuesëve në Maqedoninë e Veriut kanë aplikuar për vende pune jashtë shtetit.⁶² Ngjashëm, rreth 300 mjekë të kualifikuar dhe të punësuar u larguan nga Bosnja dhe Hercegovina në vitin 2016, pasuar nga shumë tjerë të cilët u larguan menjëherë pas përfundimit të shkollimit.⁶³ Llogaritet se rreth 150 mijë euro shpenzohen për edukimin e një mjeku në Bosnjë dhe Hercegovinë, që nënkupton se shteti shpenzon më shumë se 50 milionë euro në vit për mjekët të cilët zgjedhin të largohen nga vendlindja e tyre.⁶⁴

Të rinjtë dhe personat me nivel të lartë të edukimit janë më të prirur të emigrojnë dhe janë të mbipërfaqësuar në mes të migrantëve në vendet e destinacionit. Në vitin 2010, 30–45% e migrantëve të cilët u larguan nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, kishin nivel të lartë të edukimit. Në këtë mënyrë, shtetet e Ballkanit Perëndimor janë më të rrezikuar në largimin e trurit, në veçanti të rinjtë.⁶⁵ Në anën tjetër, shtetet e BE-së përfitojnë dukshëm nga kjo lëvizje e popullsisë. Disa ekonomistë vlerësojnë se Gjermania ka përfituar rreth 200 miliardë euro për vitet 2009–2016 si pasojë e kualifikimeve të fuqisë punëtore me origjinë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.⁶⁶

Roli i politikave zhvillimore në zbutjen e prirjes për emigrim

Politikat publike mund të ndikojnë ndjeshëm në vendimet e njerëzve për të emigruar. Shumë vende të shqetësuar për shkallën e lartë të emigrimit mes qytetarëve të tyre kanë zbatuar strategji për t'i nxitur ata të qëndrojnë brenda kufijve. Për shembull, dëshira për të emigruar priret të jetë më e ulët në vendet që ndajnë një pjesë më të madhe të buxhetit të tyre për programet e mbrojtjes sociale.⁶⁷ Politikat që kontribuojnë në përputhjen e nevojave me ofertën, kanë tendencë të ulin emigrimin duke pasur parasysh se mungesa e vendeve të punës është një faktor i rëndësishëm që nxit atë.⁶⁸ Disa nga masat tjera përfshijnë zgjerimin e programeve arsimore, trajnimeve dhe rritjen e mundësive të punësimit në familje.⁶⁹

Për më tepër, disa vende kanë miratuar politika që synojnë të mbajnë individë me grupe të veçanta aftësish, si punonjësit e kujdesit shëndetësor, për të cilët ka mungesë të ofertës në vendet e origjinës, por janë gjithashtu në kërkesë të lartë në vendet e destinacioneve.⁷⁰ Për të dekurajuar largimin e punonjësve shëndetësorë (mjekëve dhe infermierëve) disa qeveri kanë propozuar një kombinim masash që do të krijonin kushte më të favorshme pune dhe përfitime më të mëdha, por gjithashtu do të ndalonin diplomat e të sapodiplomuarve për një periudhë të caktuar kohore.⁷¹ Politika tjera për ta luftuar dukurinë e emigrimit ishin humbja e privilegjeve sikur pensionet për emigrantët. Propozimet për të

[përmbylljen e vazhdueshme të kërkesave nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Partneritetit](#), 2021.

61 Ikonomi, Luljeta. [Ndikimi i Liberalizimit të Vizave për Ballkanin Perëndimor: Rasti i Shqipërisë](#), 2012.

62 Kostić, Marina and Proroković, Dušan. [Vendi dhe kuptimi i procesit të liberalizimit të vizave dhe emigrimi i mëtejshëm nga Ballkani Perëndimor](#). fq. 48–64, 2019.

63 Po, aty.

64 Vracic, Alida. [Rruga e kthimit: Ika e trurit dhe prosperiteti në Ballkanin Perëndimor](#), 2018

65 Banka Botërore. [Trendet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor](#), 2020

66 Allison Carragher. [BE është një ndërmjetës i pandershëm për demografinë e Ballkanit Perëndimor](#), 2021.

67 OBZHE. [Marrëdhëniet ndërmjet politikave publike, migrimit dhe zhvillimit](#).

68 Po aty.

69 Po aty.

70 Kombet e Bashkuara. [Politikat ndërkombëtare të migrimit, pikëpamjet dhe prioritetet e qeverisë](#)

71 Sagoe, K. [Ndalesa e emigrimit të punëtorëve shëndetësor në Gana](#).

futur 'taksat e ikjes së trurit' dhe skema të tjera janë avancuar në disa vende që kanë krijuar obligime që duhet të përmbushën nga shtetas të cilët janë arsimuar me shpenzimet e qeverisë dhe kërkojnë leje daljeje jashtë vendit.⁷²

Shumica e qeverive të tjera nuk synojnë të dekurajojnë emigrimin, por fokusohen në sigurimin e përfitimeve për ekonominë kombëtare, veçanërisht nëpërmjet maksimizimit të remitancave. Shteti i Irlandës, arriti të përdorë emigracionin për të "rivendosur" besueshmërinë e tij ndërkombëtare pasi u ballafaqua me një ikje të lartë të trurit në vitet 1990.⁷³ Nëpërmjet një riemërtimi të fokusuar plotësisht në shfrytëzimin e potencialit të diasporës për zhvillim ekonomik – i cili u mbështet fuqishëm nga media, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile – Irlanda arriti ndryshim historik drejt kthimit dhe politikave të migrimit qarkullues.⁷⁴

Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë përdorur politika të parandalimit të emigrimit të drejtura te papunësia si problemi më i spikatur për të rinjtë.⁷⁵ Qeveritë janë fokusuar veçanërisht në masat aktive të tregut të punës për të rinjtë nga grupet e cenueshme dhe në mbështetjen për sipërmarrjen e të rinjve dhe punësimin në biznes, si grantet, subvencionet, praktikant, rikualifikimi dhe ngritja e aftësive. Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë implementuar sisteme të arsimit të dyfishtë ngjashëm me vendet e zhvilluara evropiane.⁷⁶ Këto shtete kanë miratuar strategji, dokumentet e të cilave përmbajnë masa politike për të tërhequr kryesisht investime nga diaspora; për të promovuar migrimin qarkullues dhe kthimin e anëtarëve të kualifikuar të diasporës; për të lidhur diasporat; dhe për të krijuar instrumente të reja financiare për mbështetjen e investimeve të diasporës (në formën e Fondeve për Zhvillimin e Diasporës, Bankave të Diasporës, apo Sindikatave të Biznesit të Diasporës).⁷⁷

Përkundër përpjekjeve, shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë arritur të investojnë në mënyrë adekuate për të synuar të gjitha segmentet kritike të tregut të punës. Investimet në arsimin publik janë të pamjaftueshme, ndërkohë që politikat arsimore nuk janë të përqendruara në aftësitë e kërkuara nga tregjet moderne dhe teknologjike të punës.⁷⁸ Burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike të shërbimeve publike të punësimit janë veçanërisht të kufizuara; si institucionet kryesore të përfshira, këto karakterizohen nga mospërputhja, mungesa e transparencës dhe koordinimi i dobët ndërsektorial.⁷⁹

Ndër arsyet që nxisin emigrimin nga Kosova janë edhe pakënaqësia e qytetarëve me cilësinë në arsim dhe shërbimet në sektorin e shëndetësisë, respektivisht. Sipas Raportit të progresit për Kosovën për vitin 2023 të Komisionit Evropian, sistemi i arsimit mbetet një nga më të pazhvilluarit në Kosovë.⁸⁰ Cilësia e arsimit është e ulët, e cila reflektohet edhe në rezultatet e fundit të testit PISA të

72 Po aty.

73 Mary, R, [Presidenca e Irlandës: adresim](#), shkurt 1995.

74 Alida, V. [Fat si irlandezët: Si mund të jetë i mirë emigracioni për Ballkanin Perëndimor](#), Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, 2019

75 Grupi i Bankës Botërore dhe Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, [Trendet e Tregut të Punës në Ballkanin Perëndimor](#), 2020

76 Po aty.

77 Shqipëria ka miratuar një Strategji Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe një Strategji Kombëtare të Diasporës 2018–2024. Në Bosnje dhe Hercegovinë, një politikë për bashkëpunim me diasporën u miratua në vitin 2017. Maqedonia e Veriut miratoi Strategjinë e saj të parë për ikjen e trurit në 2013 dhe dy rezoluta për migracionin në 2015 dhe 2017. Serbia në 2012 shpalli Strategjinë e Migracionit Ekonomik 2021–2027 për të mbështetur kthimin dhe migrimin qarkullues. Kosova miratoi Ligjin për Diasporën në vitin 2011 dhe Strategjinë për Diasporën 2014–2017 me fokus në luftimin e migrimit të parregullt në BE. Mali i Zi miratoi Strategjinë 2017–2020 për Menaxhimin e Integruar të Migracionit dhe Ligjin për Bashkëpunim me Diasporën në vitin 2018. Valeska, E. et al., [Emigrimi nga Ballkani Perëndimor](#), Instituti Aspen Gjermani, 2021.

78 Grupi i Bankës Botërore dhe Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, [Trendet e Tregut të Punës në Ballkanin Perëndimor](#), 2020

79 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, [Studim mbi Punësimin e të Rinjve në Ballkanin Perëndimor](#), 2021.

80 OBZHE, [Rezultatet e testit PISA 2022](#).

Organizatës Botërore për Zhvillim Ekonomik (OBZHE), ku Kosova radhitet ndër shtetet e fundit në listë (në vendin 78 nga 80 shtete pjesëmarrëse).⁸¹ Në anën tjetër, sipas të njejtit raport, gjendja e rënduar e shëndetësisë, jetëgjatësia më e ulët në rajon, vdekjet e fëmijëve, vdekjet nga sëmundjet kronike, mungesa e aparaturave adekuate, listat e gjata të pritjeve, dhe mungesa e investimeve në shëndetësi janë disa nga faktorët të cilët e rëndojnë gjendjen e shëndetit publik në Kosovë. Këto të fundit, padyshim, ndikojnë në dekurajimin e qytetarëve për të qëndruar në vend.

Mungesa e të dhënave të emigrimit është një nga faktorët që pengon formulimin e politikave cilësore të adresimit të emigrimit. Vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, i mungojnë të dhëna të besueshme, të qasshme dhe sistematike për sa i përket vëllimit, karakteristikave, moshës ose përbërjes së aftësive të emigrantëve, gjë që është një parakusht për një proces gjithëpërfshirës të politikave.⁸²

81 Po aty.

82 Icoski, Marjan. [Drejt një paradigme të re të ikjes së trurit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor](#), GMF, 2022.

Përfundime dhe rekomandime

Emigrimi nga shtetet e Ballkanit Perëndimor drejt shteteve të zhvilluara të Bashkimit Evropian, në masë të madhe po e ndikon edhe Kosovën. Ndonëse Kosova është shteti i vetëm në rajon i cili ishte i kufizuar nga lëvizja e lirë në zonën Schengen, reformat e tërheqjes së emigrantëve nga shtetet BE-së kanë ndikuar që emigrimi nga Kosova të rritet. Liberalizimi i vizave e gjen Kosovën në një dinamike më ndryshe se shtetet tjera të rajonit në kohën kur atyre i'u ofrua lëvizja e lirë në BE. Tregu i punës në Kosovë vazhdon të sfidohet nga mungesa e fuqisë punëtore, e cila pritet të thellohet më shumë me liberalizimin e vizave.

Gjetjet e hulumtimit të Institutit GAP të realizuara nga matja e opinionit publik tregojnë se 27.9% e popullsisë planifikojnë të emigrojnë nga Kosova në tremujorin e parë të 2024. Moshë e cila dominon përfaqëson kryesisht të rinjtë, të motivuar nga pritshmëritë për paga më të larta dhe kushte më të mira të punës në vendet e destinacionit. Sektorët të cilët priten të jenë më të ndikuar nga emigrimi janë ndërtimtaria, hoteleria dhe transporti si dhe tregtia me shumicë dhe pakicë. Nga viti 2012 deri në vitin 2022, nga Kosova kanë emigruar gjithsej 338,068 qytetarë. Vetëm duke u bazuar në të dhënat e fundit të vitit 2022, nga Kosova emigruan 41,553 persona. Në të njëjtën kohë, fuqia punëtore aktive është zvogëluar për 21,571 persona ndërsa fuqia punëtore jo-aktive është zvogëluar për 14,698 krahasuar me një vit paraprak. Shtetasit e huaj të cilët imigrojnë në Kosovë për arsye punësimi, zëvendësojnë vetëm një pjesë të vogël të fuqisë punëtore që nuk janë më pjesë e tregut të punës.

Adresimi i çështjes së emigrimit nga Kosova kërkon adresimin e një sërë faktorësh ekonomikë, politikë dhe social të cilët kontribuojnë në largimin e njerëzve nga vendi. Duke pasur parasysh që vetë natyra e kontrollit të emigrimit cenon lirinë e lëvizjes së individëve, hartimit të politikave të emigrimit duhet t'i kushtohet rëndësi dhe kujdes. Me anë të këtij raporti, Instituti GAP inkurajon Qeverinë e Kosovës të punojë në:

- » Zbatimin e politikave dhe iniciativave që stimulojnë rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Kjo mund të përfshijë mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tërheqjen e investimeve të huaja dhe promovimin e sipërmarrjeve;
- » Zhvillimin e aftësive siç është investimi në programet e arsimit dhe formimit profesional për të rritur aftësitë e fuqisë punëtore dhe për t'i përshtatur ato me kërkesat e tregut të punës;
- » Përmirësimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe arsimor për të ngritur cilësinë e jetës për qytetarët;
- » Programe të diasporës të cilat inkurajojnë lidhjen e qytetarëve në Kosovë me diasporën e Kosovës për të nxitur përfshirjen e tyre në zhvillimin e vendit. Kjo mund të drejtojë në krijimin e programeve që lejojnë diasporën të kontribuojë në projekte ekonomike dhe sociale;
- » Inkurajimin e zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit. Përqendrimi në këto fusha mund të tërheqë një fuqi punëtore më të re, me njohuri teknologjike dhe të krijojë mundësi të reja;
- » Planifikimin strategjik dhe zhvillimin e planeve afatgjata që adresojnë shkaqet rrënjësore të emigrimit dhe ofrojnë një udhërrëfyes për zhvillim të qëndrueshëm;
- » Grumbullimin e të dhënave sistematike për vëllimin, moshën, aftësitë dhe karakteristika tjera të emigrantëve, në mënyrë që parashikimet të nevojave të tregut të punës në Kosovë të jenë sa më të sakta.


Shtojca

Tabela 3. Migrimi neto i kosovarëve në disa prej destinacioneve kryesore të BE-së (2019 – 2022)

	Gjermani	Zvicër	Austri	Belgjikë	Kroaci
2022	17,348	1,735	751	349	912
2021	17,164	1,762	559	308	110
2020	11,055	1,448	308	232	787
2019	15,711	1,734	602	251	3,038


Burimi: Agjencitë e Statistikave të shteteve të lartpërmendura

Figura 15. Migrimi i Kosovarëve në Gjermani (2019–2022)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Gjermanisë


Figura 16. Migrimi i Kosovarëve në Zvicër (2019–2022)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Zvicrës

Figura 17. Migrimi i Kosovarëve në Austri (2019–2022)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Austrisë

Figura 18. Migrimi i Kosovarëve në Kroaci (2019–2022)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kroacisë

Figura 19. Migrimi neto i Kosovarëve në Belgjikë (2019–2022)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Belgjikës

Figura 20. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Kosovës




Figura 21. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Shqipërisë






Figura 22. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Maqedonisë së Veriut




Burimi: Eurostat

Figura 23. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Serbisë




Burimi: Eurostat

Figura 24. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Malit të Zi



Burimi: Eurostat

Figura 25. Leje-qëndrimet për herë të parë në BE për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës



Burimi: Eurostat

Tabela 4. Leje-qëndrimet për shtetasit e huaj në Kosovë (2022)

2022	Gjithsej	Bashkim familjar	Punësim	Studime	Humanitare	Tjera
Gjithsej	6,244	2,740	2,979	400	78	47
Shqiperia	1,789	1,050	691	28	0	28
Serbia	1,297	627	469	193	0	8
Turqia	1,197	297	742	125	33	0
Maqedonia e Veriut	643	375	250	15	0	3
SHBA	259	51	192	16	0	0
Mali i Zi	111	57	41	12	0	0
Gjermania	103	37	55	1	0	1
Britania e Madhe	54	22	32	0	0	0
Filipinet	53	3	50	0	0	0
Zvicra	50	32	18	0	0	0
Italia	46	7	38	1	0	0
Pakistani	43	3	38	2	0	0
Bosnja dhe Hercegovina	36	14	21	1	0	0
Franca	36	8	25	3	0	0
Tailanda	27	0	27	0	0	0
Jordania	24	1	23	0	0	0
Siria	24	1	23	0	12	0
Kina	21	2	19	0	0	0
Tjera	431	153	225	3	33	7

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

Tabela 5. Leje-qëndrimet për shtetasit e huaj (2021)

2021	Gjithsej	Bashkim familjar	Punësim	Studime	Humanitare	Tjera
Gjithsej	4,279	1,861	2,121	226	51	20
Shqipëria	1,203	638	543	16	0	6
Serbia	936	455	339	137	15	0
Turqia	692	195	431	46	15	5
Maqedonia e Veriut	459	268	184	7	0	0
SHBA	167	37	130	0	0	0
Mali i Zi	90	51	25	14	0	0
Gjermania	55	21	33	0	0	1
Filipinet	40	2	38	0	0	0
Bosnja dhe Hercegovina	39	13	26	0	0	0
Britania e Madhe	39	11	28	0	0	0
Italia	38	4	34	0	0	0
Zvicra	33	21	12	0	0	0
Kina	27	1	26	0	0	0
Pakistani	27	2	23	2	0	0
Siria	24	8	0	0	16	0
Kroacia	22	4	18	0	0	0
Franca	21	3	18	0	0	0
India	19	3	16	0	0	0
Tjera	348	124	197	4	5	8

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339


info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



**Prirja për të emigruar nga Kosova
pas liberalizimit të vizave:
ndikimi në fuqinë punëtore**